



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 31, datë 27.04.2018

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 4, DATË 29.02.2012, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË
KONSUMATORËVE PËR DISA KLIENTË TË VEÇANTË"**

Në mbështetje të nenit 14, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe bazuar në relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatoi:

Komisioni Kombëtar Rregullator me anë të vendimit nr. 4, datë 29.02.2012, "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë", pika 1/b ka klasifikuar komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit) në kategorinë e konsumatorëve publikë.

Konferenca Ipushkvnore e Shqipërisë me anë të shkresës nr. 04/18, datë 25.02.2018, me lëndë "Mbi nevojën e rishikimit të tarifës së furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për Objektet e Bashkësive Fetare" iu drejtua Entit Rregullator të Ujit me kërkesën për kategorizimin e Objekteve të Bashkësive Fetare si konsumatorë familjarë, mbështetur edhe në praktikën e ngjashme me shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 4, datë 29.02.2012, "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë", pika 1/b ndryshohet si më poshtë:

"Komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit) të trajtohen në kategorinë "Klientë familjarë". Këtu bëjnë përjashtim ato institucione dhe struktura të krijuara nga këto komunitete të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, të cilat do të trajtohen në kategorinë "Klient privat".

2. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit të njoftojë të gjitha shoqëritë ujësjellës kanalizime dhe përfaqësitë e bashkësive fetare.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 qershor 2018.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani